




SHQIPËRI VS UKRAINË



UEFA
NATIONS
LEAGUE™

19
NËNTOR
2024

20:45

AIR ALBANIA
STADIUM



SHQIPËRI VS ÇEKI

16
NËNTOR
2024

20:45

AIR ALBANIA
STADIUM

LIGA B | GRUPI 1



TË DASHURTIFOZË TË KOMBËTARES KUQEZI, MIQ E FUTBOLLDASHËS,

Kombëtarja jonë e dashur po përgatitet prej gati një jave për të zbritur në fushën e lojës e për të përfaqësuar me krenari flamurin dhe ngjyrat tona kombëtare në dy sfidat vendimtare që do të përmbyllin këtë vit të jashtëzakonshëm kalendarik për futbollin shqiptar.

Një vit që kulmoi me pjesëmarrjen e paharrueshme të Shqipërisë në finalët e Kampionatit European "Gjermani 2024" për të vijuar më pas me paraqitje mjaft të bukura në UEFA Nations League që na kanë dhuruar shumë emocione të bukura.

Kuqezinjtë do të përballen me Çekinë më 16 nëntor dhe Ukrainën më 19 nëntor me të dyja sfidat që do të zhvillohen në stadiumin tonë ikonik "Air Albania" me synimin e qartë për të marrë maksimumin e pikëve dhe për t'u renditur të parët e grupit. Një pozicion që do ta kualifikonte automatikisht për në Ligën A të Nations League.

Pas fitores aq të rëndësishme ndaj Gjeorgjisë në transfertë, skuadra jonë ka treguar se ka potencial të madh dhe mundësi për të arritur rezultate edhe më të mëdha në të ardhmen dhe për shënuar progres të dukshëm. Në UEFA Nations League, djemtë tanë kanë zhvilluar ndeshje plot grintë e përkushtim, duke dhënë gjithçka për të nderuar Shqipërinë. Tashmë është e qartë se skuadra jonë është në rrugën e duhur dhe se ëndrra për të shkuar më lart në arenën ndërkombëtare është gjithnjë e më afër.

Shqipëria po prodhon talente të jashtëzakonshme, të cilët po shkëlqejnë në arenën ndërkombëtare dhe po bëjnë që emri i vendit tonë të dëgjohet kudo. Ky brez i artë lojtarësh na jep besim të palëkundur se e ardhmja jonë është e ndritur. Me këta djem të përkushtuar dhe me mbështetjen e pakushtëzuar të publikut tonë të shkëlqyer, asgjë nuk është e pamundur.

Ndeshja e së shtunës ndaj Çekisë është një moment vendimtar për ne, një mundësi e artë për t'iu afruar objektivit tonë kryesor – vendit të parë në grup. Pas saj, do të fokusohemi tek sfida e fundit ndaj Ukrainës, një tjetër përballje që kërkon përqendrim dhe përpjekje maksimale. Janë dy ndeshje të vështira, por të gjitha sfidat janë të kapërcyeshme kur bashkohemi si një komb.

Dua të falënderoj nga zemra çdo lojtar, trajner dhe staf teknik për punën dhe përkushtimin e tyre të jashtëzakonshëm. Falë tyre, ky ekip ka arritur të tregojë një nivel të lartë profesionalizmi dhe dëshirë për të përfaqësuar Shqipërinë në mënyrën më të denjë.

Por mbi të gjitha, falënderimi më i madh shkon për ju – tifozët kuqezi, lojtari ynë i "12"-të, forca shtytëse që e motivon këtë ekip të luftojë deri në fund. Stadiumi "Air Albania", i mbushur me pasionin dhe energjinë tuaj, shndërrohet në një fortesë të pakalueshme për çdo kundërshtar. Në këto dy sfida të rëndësishme, mbështetja juaj do të jetë vendimtare. Jam i bindur se tifozeria jonë e mrekullueshme do të bëjë gjithashtu një paraqitje po aq të mirë e dinjitoze në tribunat e stadiumit dhe të tregojë respekt për kundërshtarët, njësoj si futbollistët në fushën e lojës. T'i tregojmë botës se jemi një popull i qytetëruar dhe që mbartim vlerat më të mira europiane.

Të bashkohemi të gjithë si një, të tregojmë se sa shumë kemi rritur si një komb dhe të japim gjithçka për të mbështetur ekipin tonë të zemrës. Kombëtarja është krenaria jonë më e madhe, simboli i unitetit dhe forcës sonë si popull.

Uroj që të gjithë së bashku të shijojmë dy ndeshje plot emocione, spektakël dhe, pse jo, të festojmë edhe fitore të mëdha. Suksese ekipit tonë dhe faleminderit pafund për besimin dhe përkrahjen tuaj!

**Me respekt dhe krenari,
Armand Duka**

President i Federatës Shqiptare të Futbollit

**WHEN
EVERYTHING
IS IN YOUR
HANDS**

**BECOME
YOUR OWN
HERO.**

ama[®]
CAPSULE



Kapsula të përshtatshme për aparat Nespresso*

ama Boutique, Rruga Vaso Pasha, Tiranë

shop.amacaffe.com

PROFIL

Sylvio Mendes Campos Junior është trajneri i dytë i Kombëtares shqiptare që pas kualifikimit të dytë kuqezinjve në një kampionat European 'bëhet' shqiptar me letra. I pari ishte Gianni De Biasi, i cili përveç se gëzon nënshtetësinë shqiptare, di edhe disa fjalë shqip.

Këtë po bën edhe tekniku aktual i Shqipërisë, i cili shpesh në konferencat e tij për media apo edhe në shëtitjet që bën me stafin në kryeqytet, mundohet të flasë ndonjë fjalë tek-tuk shqip, si për të treguar që e meriton pasaportën shqiptare. "Mirëmëngjes! Përshëndetje, si je mirë?", kështu nis dita e Sylvinhos në zyrat e Federatës së Futbollit çdo ditë pas rinovimit të kontratës së re.

I lindur në Brazil, i rritur në qytetet e mëdha të Europës, në Londër, Barcelonë e Manchester, Sylvinho nuk është druajtur kurrë nga sfidat. As kur ishte futbollist e fitoi tituj me Barcelonën në Spanjë e Europë dhe as kur vendosi të varë këpucët në gozhdë e t'i futej rrugës së trajningut.

Gjithmonë me këmbë në tokë, duke mos synuar në mënyrë direkte majat, ai e nisi si zëvendës-trajner në 2011 tek ekipi i Cruzeiro, e më pas te Sport Recife dhe Náutico.

Rrugëtimi do të vazhdonte tek ekipi i Corinthians në 2013 si asistent i Tites, përpara se t'i vinte edhe oferta zyrtare nga Roberto Mancini, për të qenë ndihmësi i tij tek ekipi i Interit në 2014.

Një trajner në rritje, teksa në 2016 i erdhi oferta nga Tite për të qenë ndihmës i tij në ekipin e zemrës, Brazili. Tre vite në drejtimin e Selecao-ve dhe në 2019, Sylvio e pa veten gati për të qenë dirigjent kryesor i skuadrës së Lyon në Francë. Një eksperiencë që zgjati pak muaj për brazilianin,

i cili më pas vendosi të rikthehej sërish në vendlindjen e tij, për të drejtuar më pas skuadrën e Corinthians ku qëndroi disa muaj.

Kishte dëgjuar më parë për Shqipërinë, por nuk kishte qenë kurrë në këtë vend. Janari i vitit 2023 do ta gjente pikërisht në vendin e shqiptonjave.

Më 9 janar, Sylvinho firmosi kontratën e tij, ndoshta mund të quhet edhe kontrata e jetës. La gruan dhe fëmijët në Madrid, prindërit Brazil dhe gjithë jetën e tij të ndërtuar ndër vite për të ardhur e për të jetuar në

Shqipëri. Me një moto të vetme: "Veniam, Videbo, Vincam" – "Do të vij, do të shoh, do të fitoj"


Më 9 janar, menjëherë sapo firmosi kontratën u fut në zyrën e tij së bashku me ndihmësit e tij Doriva e Zabaletta dhe krijuan skuadrën e destinuar për t'u kualifikuar në Europeanin "Gjermani 2024". 15 pikë të grumbulluara, vendi i parë në grupin E, 4 fitore, 3 barazime e 1 humbje. Ndoshta, as në ëndrra nuk e kishte imagjinuar një fushatë të tillë kualifikuesesh por ia doli.

Pak javë para se të shkonte në Gjermani, Sylvinhos u pajis edhe me pasaportën shqiptare. "Mirëmëngjes! Përshëndetje, si je mirë?", kështu nis dita e Sylvinhos në zyrat e Federatës së Futbollit çdo ditë pas rinovimit të kontratës së re. Liga e Kombeve është sfida e radhës. Do vendin e parë, do suksesin, jo vetëm për vete. E do për shqiptarët, si një ndër shqiptarët e këtij vendi. Çekia dhe Ukraina, dy betejat e radhës.

"Mirëmëngjes!
**Përshëndetje,
si je mirë?"**

**SHQIPTARI
SILVINHO**

**NË KËRKIM
TË SUKSESIT
TË RADHËS**





FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT


RRUGËTIMI I SHQIPËRISË NË NATIONS LEAGUE

NDAJ ÇEKISË PËR "HAKMARRJE". KUNDËR UKRAINËS PËR TË SHKRUAR HISTORINË

Gjërat e bukura nuk zgjasin përgjithmonë dhe pas pjesëmarrjes në finalët e Kampionatit Europian "Gjermani 2024", Shqipëria duhet të harronte gjithçka dhe të niste në shtator rrugëtimin e saj në Nations League. Kuqezinjtë janë pjesë e Ligës B, në një grup jo shumë të thjeshtë.

Përballë Gjeorgjisë që bëri shumë mirë në Europian duke u eliminuar nga Spanja në çerekfinale. Përballë Çekisë, që në këtë edicion do të kërkonte hakmarrjen për atë triumf të Shqipërisë 3-0 në "Air Albania" vitin e kaluar. Dhe përballë Ukrainës, përfaqësuesja që luan për kombin e saj kudo në Europë e vetëm në shtëpinë e saj jo për shkak të luftës me Rusinë prej vitit 2022.

Përballja e parë pikërisht ndaj Ukrainës, e zhvilluar në kryeqytetin çek, në Pragë. Kuqezinjtë e lanë pas dehjen nga Europiani dhe në fushë duhet të luanin, të prodhonin spektakël dhe të fitonin. Pas 49 minutash lojë, pësua gol nga



Ukraina. Por një skuadër e madhe di se kur duhet të reagojë dhe e bëri këtë gjë më së miri me Ardian Ismajlin dhe Jasir Asanin. Dy gola të shënuar nga qendërmbrojtësi dhe sulmuesi anësor i dhanë fitoren e parë Shqipërisë në këtë rrugëtim të ri në Nations League.

7 shtator 2024, 1-2 për Shqipërinë dhe tre pikët e para në grupin B1. Suksesi i parë pas Europianit vjen nga Praga. Tre ditë më vonë luanim në fortesën kuqezinjtë ndaj Gjeorgjisë. Në epokën "Silvinjo", kuqezinjtë nuk e kishin ndjerë shijen e humbjes në këtë stadium. Por ka gjithmonë një herë të parë dhe kjo humbje erdhi pikërisht nga Gjeorgjia, skuadra që la pa fjalë miliona tifozë në të gjithë botën për ecurinë në Europianin "Gjermani



2024". Një skuadër mjaft e konsoliduar, me ide të qarta dhe që na kishte studiuar fort mirë na mposhti minimalisht 1-0 në "Air Albania". Mbetemi në kuotën e 3 pikëve dhe për momentin gjithçka do të mbyllej këtu, për t'u rikthyer sërish në tetor. Një muaj më i vështirë se shtatori, pasi të dyja ndeshjet ishin të planifikuara në transfertë.

Fillimisht destinacioni i kuqezinjtë do të ishte sërish Praga. Kësaj radhe kundër Çekisë. Të gjithë e dinin dhe e parashikonin këtë ndeshje si shumë të luftuar. Çekët donin hakmarrje pasi ende nuk e kishin kapërdirë atë humbje 3-0 nga Shqipëria në "Air Albania". Dhe kështu ndodhi, Çekia na mundi 2-0 në "Epet Arena". Një humbje që dhëmbi shumë, por skuadra nuk duhet të humbte ekuilibrin.

Ashtu sikurse fitoret harrohen shpejt, pasi ndeshjet e radhës vijnë sa hap e mbyll sytë, edhe barazimet e humbjet duhet të fshihen nga memoria sado të dhimbshme të jenë. Dhe ky është një ndër sekretet që ka ky grup. Humbja 2-0 nga Çekia nuk i demotivoi. Përkundrazi, ndeshjen e radhës ndaj Gjeorgjisë e luajtën si sfidën e jetës. Dhe e fituan 0-1. Një triumf që shumë pak e pritën, por miliona shqiptarë e festuan sikur të kishin fituar ndaj Spanjës kampionë. Një fitore që na futi sërish në lojë për vendin e parë në grup dhe për të siguruar Ligën A në edicionin e ardhshëm e për të luajtur me skuadrat më të mira të botës. Asllani shënoi dhe e gjithë shqiptaria festoi. Për më tepër, i uruan edhe të vëllait të mesfushorit datëlindjen.

Tashmë rikthehemi në shtëpi, me dy ndeshjet ndoshta më të rëndësishme të grupit B1. Fillimisht Çekia, më 16 nëntor në ora 20:45 dhe më pas Ukraina më 19 nëntor në ora 20:45. E veçanta e këtyre dy sfidave është se luhen të dyja në "Air Albania", në një stadium sold out për të dyja ndeshjet. Rreth 22 mijë tifozë do të brohorasin dhe mbështesin Shqipërinë e tyre në këto sfida.


Kuqezinjtë me siguri nuk e kanë kaluar ende poshtë atë humbje në Pragë dhe ndaj Çekisë duan që të përsërisin mrekullinë e 13 muajve më parë. Ndërsa ndaj Ukrainës do



REZULTATET E SHQIPËRISË NË NATIONS LEAGUE



KLASIFIKIMI, GRUPI B1



të tentojnë fitoren e dytë radhazi, të papërzetuar ndonjëherë në historinë e tyre.

Mungesat në skuadrën shqiptare janë të shumta, nisur që nga kapiteni Gjimeshi, e duke vijuar me Marash Kumbullën, Keidi Baren, Rey Manaj e Armando Broja. Por fatmirësisht, ashtu sikurse edhe gjatë kualifikuesëve të Europianit, Shqipëria tashmë ka një skuadër yjesh në fushë dhe një skuadër yjesh në stol.

6, 4, 3, 2, 1 apo 0 pikë. Këtë nuk e dimë. Dëshira është për 6 pikë. Në një rrugëtim kaq të paimagjinueshëm sa ky këtë herë, e vështirë të parashikohet. Ne na mbetet të mbështesim kuqezinjtë nga shkallët e stadiumeve. Kurse atyre të shënojnë e të fitojnë.



Sponsor i
Kombëtares
Shqiptare

Skano për
më shumë



STAFI TEKNIK I KOMBËTARES



SHQIPËRIA



Bashkohu me ekipin më të mirë.

Aktivitetet sportive mund të shoqërohen edhe me dëmtime por me Sigurimin e Aksidentëve të Sportistëve nga SIGAL je i mbrojtur financiarisht.

Sigurimi i sportistëve?

Apliko Online

Më mirë tani.



Your journey continues through
INFINITY

OUR SERVICES



Infinity Destinations (DMC) is a professional services organization that specializes in planning, organizing and managing various aspects of travel and events in a given destination.



We have detailed knowledge of the local area, including attractions, accommodations, transportation options, cultural nuances and logistical considerations.



We work closely with our clients to understand their goals, preferences and budget constraints, and then use our local knowledge and connections to design and deliver personalized experiences.

OUR HISTORY

Infinity Destinations was founded in 2013, offering exceptional customer service and customized travel packages. Over the years, the agency expanded its offerings to include adventure tourism, luxury cruises and cultural tourism.

OUR VISION

To be a leading service provider in travel management solutions- an entrepreneurial, innovative and inspiring company of choice for employees, customers, partners and shareholders.

OUR MISSION

We will demonstrate a return of investment to our customers and suppliers. We will empower our teams to make the best decisions for our customers. Our shareholders will be at the forefront of our business growth strategy.

CONTACT US





LISTA E KOMBËTARES SË ÇEKISË




EMËR	MBIEMËR	POZICIONI	KLUBI KU LUAN
Martin	Jedlička	Portier	FC Viktoria Plzeň
Antonín	Kinský	Portier	SK Slavia Praha
Matěj	Kovář	Portier	Bayer 04 Leverkusen
Jan	Bořil	Mbrojtës	SK Slavia Praha
Vladimír	Coufal	Mbrojtës	West Ham United FC
Milan	Havel	Mbrojtës	FC Viktoria Plzeň
Tomáš	Holeš	Mbrojtës	SK Slavia Praha
Václav	Jemelka	Mbrojtës	FC Viktoria Plzeň
Patrizio	Stronati	Mbrojtës	Puskás Akadémia FC
Jiří	Boula	Mesfushor	FC Baník Ostrava
Václav	Černý	Mesfushor	Rangers FC
Lukáš	Červ	Mesfushor	FC Viktoria Plzeň
Alex	Král	Mesfushor	RCD Espanyol
Ondřej	Lingr	Mesfushor	SK Slavia Praha
Lukáš	Provod	Mesfushor	SK Slavia Praha
Tomáš	Souček	Mesfushor	West Ham United FC
Matěj	Šín	Mesfushor	FC Baník Ostrava
Pavel	Šulc	Mesfushor	FC Viktoria Plzeň
Adam	Hložek	Sulmues	TSG 1899 Hoffenheim
Jan	Kliment	Sulmues	SK Sigma Olomouc
Jan	Kuchta	Sulmues	FC Midtjylland
Vasil	Kušej	Sulmues	FK Mladá Boleslav
Tomáš	Chorý	Sulmues	SK Slavia Praha

TRAJNER: IVAN HASEK

Ti zgjidh ku, ne i çojmë atje.

Kudo ku dëshironi të shkojnë paratë
tuaja, ne do kujdesemi për to.





Me një kreativitet që nuk njih moshë, ne lëvizim me lehtësinë e një lepuri dhe mprehtësinë e një mendjeje strategjike. Mjaft të pjekur për të krijuar histori që zgjasin, por mjaft të çlirët për të parë botën me sy të freskët, çdo ditë!

ZYRTARËT E NDESHJES SHQIPËRI – ÇEKI

ROLI	EMËR / MBIEMËR	KOMBËSIA
Arbitër	SANDRO SCHÄRER	Zvicër
Asistent i parë	STÉPHANE DE ALMEIDA	Zvicër
Asistent i dytë	JONAS ERNI	Zvicër
Arbitër i katërt	JOHANNES VON MANDACH	Zvicër
VAR	FEDAYI SAN	Zvicër
Asistent VAR	LIONEL TSCHUDI	Zvicër
Vëzhgues	EMIL BOZHINOVSKI	Maqedoni e Veriut
Delegat	BJÖRN FECKER	Gjermani



#EQUALGAME



KARROTA.WTF

HISTORIKU I PËRBALLJEVE

SHQIPËRI **VS** ÇEKOSLLOVAKI / SHQIPËRI **VS** ÇEKI



PËRBALLJET SHQIPËRI - ÇEKOSLLOVAKI

17 SHTATOR 1950

ÇEKOSLLOVAKI 3

SHQIPËRI 0

29 NËNTOR 1952

SHQIPËRI 3

ÇEKOSLLOVAKI 2

7 DHJETOR 1952

SHQIPËRI 2

ÇEKOSLLOVAKI 1

1 MAJ 1991

SHQIPËRI 0

ÇEKOSLLOVAKI 2

16 TETOR 1991

SHQIPËRI 2

ÇEKOSLLOVAKI 1

PËRBALLJET SHQIPËRI - ÇEKI

8 QERSHOR 2021

ÇEKI 3

SHQIPËRI 1

7 SHTATOR 2023

ÇEKI 1

SHQIPËRI 1

12 TETOR 2023


SHQIPËRI 3

ÇEKI 0

11 TETOR 2024

ÇEKI 2

SHQIPËRI 0



Ndeshja e sotme përballë Çekisë është e 10-ta mes dy përfaqësuesve tona. Ose më saktë, kjo është përballja e pestë me Çekinë, pasi 5 sfidat e tjera janë zhvilluar kundër përfaqësuesve të Çekosllovakisë. Për herë të parë kemi luajtur kundër Çekosllovakisë në 1950, në një miqësore të zhvilluar në Çeki, ku u mposhtëm 3-0.

Miqësoret e radhës të propozuara për t'u luajtur në Tiranë përballë publikut shqiptar shkuan më mirë sesa mendohej. Kuqëzinjtë fituan brenda pak ditëve dy herë. Fillimisht më 29 nëntor 1952, Shqipëria

triumfoi me rezultatin 3-2, me golat e realizuar nga Gjinali, Teliti e Jareci, ndërsa më 7 dhjetor 1952 kuqëzinjtë triumfuan 2-1 me gola të shënuar nga Gjinali e Boriçi.

Zyrtarisht, Shqipëria do të përballej me Çekosllovakinë 29 vite më vonë, më 1 maj 1991. Në një epokë tranzicioni për Shqipërinë e shqiptarët, as ekipi ynë nuk mund t'i shpëtonte eksodit të futbollistëve dhe mungesës së vëmendjes nga institucionet, shoqëruar edhe me vështirësitë financiare. Në të dyja këto takime zyrtare të vlefshme për kualifikueset e Europianit, u

mposhtëm nga Çekosllovakia. Më 1 maj 1991 në Tiranë u mundëm 0-2 dhe më 16 tetor në Çekosllovakia 2-1. Golin për shqiptarët e shënoi Hysen Zmijani.

30 vite më vonë, vjen sërish mundësia për t'u përballur me Çekinë, në një miqësore të zhvilluar në Pragë ku çekët fituan me rezultatin 3-1. Golin e nderit për kuqëzinjtë e realizoi Sokol Cikallesi.

Fati i përballi sërish këto dy skuadra në kualifikueset e Europianit "Gjermani 2024". Fillimisht më 7 shtator 2024, në ndeshjen e parë të zhvilluar në Pragë, dy skuadrat u ndanë në barazimin 1-1. Më

pas, kuqëzinjtë shkruan historinë në Tiranë, duke fituar me rezultatin e çmendur 3-0. Një fitore që i dha Shqipërisë tre pikët e arta dhe thujt një vend të sigurt në finalen e Europianit 2024.

Tashmë, të dyja përfaqësueset janë pjesë e grupit B1 në Nations League. Më 11 tetor, Çekia u hakmorr për atë fitore të kuqëzinjve vitin e kaluar, duke fituar në "Epet Arena" 2-0. Tashmë, është radha e Shqipërisë për të ribërë mrekullinë dhe për të treguar se fitorja e vjetshme nuk ishte rastësi. Ishte punë, lodhje, sakrificë. Ishte ëndërr për t'u realizuar.



LISTA E KOMBËTARËS SË UKRAINËS



EMËR	MBIEMËR	POZICIONI	KLUBI KU LUAN
Georgiy	Bushchan	Portier	FC Dynamo Kyiv
Anatoliy	Trubin	Portier	S.L. Benfica
Dmytro	Riznyk	Portier	FC Shakhtar Donetsk
Yukhym	Konoplia	Mbrojtës	FC Shakhtar Donetsk
Valeriy	Bondar	Mbrojtës	FC Shakhtar Donetsk
Maksym	Talovierov	Mbrojtës	LASK
Illia	Zabarnyi	Mbrojtës	A.F.C. Bournemouth
Vitalii	Mykolenko	Mbrojtës	Everton F.C
Oleksandr	Zinchenko	Mbrojtës	Arsenal F.C.
Mykola	Matviyenko	Mbrojtës	FC Shakhtar Donetsk
Oleksiy	Sych	Mbrojtës	Rukh Lviv
Oleksandr	Nazarenko	Mesfushor	Polissya Zhytomyr
Ehor	Yarmoliuk	Mesfushor	Brentford F.C.
Georgiy	Sudakov	Mesfushor	FC Shakhtar Donetsk
Mykola	Shaparenko	Mesfushor	FC Dynamo Kyiv
Ivan	Kaliuzhnyi	Mesfushor	FC Oleksandriya
Oleksii	Hutsuliak	Mesfushor	FC Polissya Zhytomyr
Oleksandr	Zubkov	Mesfushor	FC Shakhtar Donetsk
Dmytro	Kryskiv	Mesfushor	FC Shakhtar Donetsk
Volodymyr	Brazhko	Mesfushor	FC Dynamo Kyiv
Mykhailo	Mudryk	Mesfushor	Chelsea
Roman	Yaremchuk	Sulmues	Olympiacos F.C
Artem	Dovbyk	Sulmues	AS Roma
Vladyslav	Vanat	Sulmues	FC Dynamo Kyiv

TRAJNER: SERHIY STANISLAVOVYCH REBROV



UJI PERFECT NUK ËSHTË MIRAZH.
ËSHTË TEPELENE.

ujitepelene.com



HISTORIKU I PËRBALLJEVE

SHQIPËRI VS UKRAINË

ZYRTARËT E NDESHJES SHQIPËRI – UKRAINË

ROLI	EMËR / MBIEMËR	KOMBËSIA
Arbitër	JOAO PEDRO SILVA PINHEIRO	Portugali
Asistent i parë	BRUNO MIGUEL ALVES JESUS	Portugali
Asistent i dytë	LUCIANO ANTONIO GOMES MAIA	Portugali
Arbitër i katërt	JOAO ANTONIO FERREIRA GONÇALVES	Portugali
VAR	TIAGO BRUNO LOPES MARTINS	Portugali
Asistent VAR	ANDRE FILIPE DOMINGUES NARCISO	Portugali
Vëzhgues	COSTAS KAPITANIS	Qipro
Delegat	AUREL MIHAIL IONESCU	Rumani

Më 7 shtator 2024, të gjithë shqiptarët festuan si të çmendur. Fitorja ndaj Ukrainës shijoi aq shumë, jo vetëm se u arrit me përmbysje, por edhe për shkak të historisë mes këtyre dy skuadrave. Asnjëherë më parë Shqipëria nuk kishte fituar ndaj Ukrainës.

Ishin përpjekur në ndeshjen e 8 tetorit 2005, atëherë kur Andrey Shevchenko, idhulli i mijëra shqiptarëve ishte sulmues kryesor i ukrainasve, ndërsa tashmë është President i Federatës. Pas katër humbjeve, rezultati 2-2 i ndeshjes së luajtur në Dnipro, me dy gola të shënuar nga Eri Bogdani nuk ishte ai më i drejti, por për fat të keq, deri më 7 shtator 2024 mbahej mend si më pozitiv.

Shqipëria dhe Ukraina janë takuar për herë të parë dhe në mënyrë zyrtare në fushën e blertë më 29 mars të vitit 1997. Një takim i luajtur në "Qemal Stafa", ku ukrainasit fituan 0-1. Ukraina fitoi edhe ndeshjen e kthimit, të luajtur më 20 gusht 1997 me shifrat 1-0. Dy përfaqësueset u takuan sërish në 2005.



Më 9 shkurt 2005, Ukraina fitoi në Tiranë me shifrat 0-2. Më 8 tetor 2005, kuqezinjtë barazuan me golat e Erion Bogdanit. Një ndeshje e çmendur, që për pak edhe mund të fitohej. Dopieta e Bogdanit përmbysi rezultatin në 1-2, por goli i Rotanit në të 86-të shuajti ëndrrat.

Pak para nisjes së finaleve "Francë 2016", ku Shqipëria mori pjesë për herë të parë, kuqezinjtë zhvilluan një miqësore ndaj Ukrainës në Bergamo të Italisë më 3 qershor 2016. Ukrainasit fituan me rezultatin

3-1. Në miqësoren tjetër të luajtur në 3 qershor 2018, lindorët fituan 4-1.

19 vite pas një takimi zyrtar, Shqipëria do të përballej me Ukrainën në ndeshjet e vlefshme për Nations League. Sa shumë gjëra kanë ndryshuar që prej asaj kohe. Ukraina nuk luan më në shtëpi për shkak të gjendjes së luftës, por vijon të luajë për kombin në çdo stadium të përcaktuar në bashkëpunim me UEFA-n. Përballja jonë e fundit me Ukrainën ishte në Pragë. Fituam 1-2, me gola të realizuar nga Ismajli e Asani. Shqipëria shkroi historinë. Duhet të kalonin 6 ndeshje që kuqezinjtë të thyenin mallkimin e të mposhtnin Ukrainën. Më 19 nëntor, janë në kërkim të rishkrimit të historisë. Në stadiumin "Air Albania", kuqezinjtë duan të sigurojnë një tjetër fitore me çdo kusht.

PËRBALLJET SHQIPËRI – UKRAINË

29 MARS 1997
SHQIPËRI 0

UKRAINË 1

20 GUSHT 1997
UKRAINË 1

SHQIPËRI 0

9 SHKURT 2005
SHQIPËRI 0

UKRAINË 2

8 TETOR 2005
UKRAINË 2

SHQIPËRI 2

3 QERSHOR 2016
SHQIPËRI 1

UKRAINË 3

3 QERSHOR 2018
SHQIPËRI 1

UKRAINË 4

7 SHTATOR 2024
UKRAINË 1


SHQIPËRI 2

#EQUALGAME



RESPECT

Eksperienca më e mirë e Internetit FIKS në shtëpi



Vodafone GigaFibra + TV

E RE!

1 Gbps + Vodafone TV Premium FALAS

Kontratë 24 mujore

~~1,900~~
Lekë/Muaj

1,600 Lekë/Muaj

Kontratë 12 mujore

~~2,300~~
Lekë/Muaj

2,000 Lekë/Muaj

- Oferta është e vlefshme për të gjithë klientët e rinj për një kohë të limituar.
- Çmimi për kontratë 24 mujore është 1,600 Lekë/Muaj dhe përfiton Vodafone TV Premium FALAS përgjatë gjithë kohës së kontratës së nënshkruar.
- Tarifa e instalimit është 1,500 Lekë.

Together we can

